



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TE DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së	NSH “Banka Themelore e Kosovës - Bankkos” (“Ndërmarrja”)
Emri i Ndërmarrjes së Re	Ndër. e Re Bankkos Kaçanik SH.P.K (“Ndërmarrja Subsidiare”)
Vendndodhja	Kaçanik
Biznesi/Sektor i	Shërbime bankare
Prodhimet	Ndërmarrja ka funksionuar si Bankë Komerciale në Kaçanik. Në sektorin bankar është marrë me punë monetare, mbajtja e xhirollogarive, llogarive rrjedhëse dhe llogarive devizore të qytetareve. Gjithashtu me kryerjen e punëve te pagesës së shërbimeve komunale dhe shërbimeve tjera me anë të llogarive rrjedhëse të qytetareve. Kryerjen e transfer parash, pagesave, dhënie të gjitha llojeve të kredive, si dhe kredive në bazë të letrës me vlerë.
Tregu	Ndër. Re e propozuar, ofron mundësi për aktivitete të ndryshme komerciale dhe dhënie me qira palëve te treta.
Konkurrenca	Aktualisht tregu është mjaft konkurrues, pasi që në vitet e fundit në Kosovë ka pasur rritje të konsiderueshme të qiradhënies të pronave për aktiviteteve komerciale.
Ndërtesat dhe tokat	Ndërmarrja e Re “Bankkos Kaçanik” SH.P.K. përfshinë lokalitetin afarist i cili gjendet në katin perëndor dhe katin e parë të ndërtesës 8 katëshe në Rr. Emin Duraku, në qendër të Kaçanikut, me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 279 m ² , nga të cilat përdhese 170 m ² dhe në katin e parë 109 m ² (sipas matjeve në teren). Ndër.Re, nuk përfshinë pasuri të tjera të NSH-së “Banka Themelore e Kosovës – Bankkos” por vetëm asete të përshkruara në këtë dokument.
Detyrimet që do të barten:	(1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjokat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; (2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri; (3) Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet

Rr. Rexhep Mala nr.2
10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 226 889,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
- a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
 - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-se.

Shikim parcial i Ndër. Re



Informata

Departamenti për Shitje
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Dokumentet për Ofertë

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Rruga Ilir Konushevi Nr. 8
10000 Prishtinë/Pristina, Kosovo

Rr. Rexhep Mala nr.2
10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 226 889,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org